



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS



NOTER JULED A. BEQIRAJ  
ADRESA NR.4, EGNATIA  
TEL: 684050555

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 7293

Nr. koleksioni: 4177

Durres më 02/12/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2022011520429077848



A2022011520429077848

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

( TË SHOQËRISË "EURO ADITIV" SH.P.K)

Sot, më datë 02.12.2022, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

**SHITES:1-Ardian Muka**, atësia Mihal, amësia Alma, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Shoqeria Bashkimi 00690756; Nd. 63; H. 1; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 05/08/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034880953 dhe nr. personal G70805164E,

**2-Enis Mersini**, atësia Bujar, amësia Volga, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në DURRËS, me adresë Shoqeria Bashkimi 00690756; Nd. 63; H. 1; Durrës; Durrës; 2004; Durrës, lindur më 07/05/1973, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035872150 dhe nr. personal H35507194K, .

**BLERES:Ardit Jonuzi**, atësia Astrit, amësia Mirela, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Shyqyri Brari 03910131; Nd. 3; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 04/07/1988, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033025317 dhe nr. personal I80704082O, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "EURO ADITIV" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**TE DHENAT PARAPRAKE:**

1.1 Z.Ardian Muka është pronar i 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "EURO ADITIV" shpk kuota te cilat jane te lira nga cdo pretendim apo barre ne favor te te treteve.

**NENI 1****PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është kalimi i pronesisë, kundrejt shperblimit, i 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "EURO ADITIV" shpk, te zoteruara nga ortaku Ardian Mukaj, ne favor te bleresit Ardit Jonuzi.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon blerjen e kuotave të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



## **BAZA LIGJORE**

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

### **Neni 2**

#### **Çmimi dhe mënyra e pagesës**

- 2.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë “EURO ADITIV” shpk sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi është kryer përkundrejt çmimit prej 10,000 (dhjete mije) leke
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate do të paguhet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, në numrin e llogarise bankate të pales shitesë në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën Shqiperise..

### **Neni 3**

#### **Kalimi i Pronësisë**

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotërues 10% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “EURO ADITIV” shpk ,duke u bërë titullar të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë. Kjo kontrate do të regjistrohet nga bleresi pranë QKB për pasqyrimin e kalimit në pronësi të tij të 10% të kuotave të kapitalit

### **Neni 4**

#### **Garancitë**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësit se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 5**

#### **Forca Madhore**



A2022011520429077848

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardollosjve dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohej për shkak të forcave madhore ose rasti faktor.

#### **Neni 6**

##### **Interpretimi i Kontratës në tërësi**

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

#### **Neni 7**

##### **Legjislacioni i zbatueshem**

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

#### **Neni 8**

##### **Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

#### **Neni 9**

##### **Shpenzimet**

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palës blerese. Cdo takse apo tarife e cila lidhet me kalimin e pronësisë të kuotave si dhe cdo detyrim tjetër që lind si rrjedhojë e përmbushjes së termave të kësaj kontrate do të paguhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

#### **Neni 10**

##### **Ndryshimet**

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

#### **Neni 11**

##### **Anekset e Kontrates**

- 11.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;



A2022011520429077848

- Vendimi i Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakëve te Shoqërisë "EURO ADITIV" shpk;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "EURO ADITIV" Sh.p.k
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Faturë e transfertës bankare ;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

### Neni 12

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

12.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

12.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

12.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpusoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### PALËT KONTRAKTUESE

#### SHITES

Ardian Muka

Enis Mersini

#### BLERES

Ardit Jonuzi

NOTER

JULED A. BEQIRAJ